



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI MARKETING TURIZËM



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

Hyrje në Marketing

Ngarkesa: 3 kredite, 30 orë leksione dhe 15 orë ushtrime.

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje

Programi i studimit: Program studimi profesionale dy vjeçar në Komunikim shumëgjuhësh në Institucione dhe Ndërmarrje

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Marketingu është një fushë dinamike që merret me identifikimin dhe plotësimin e nevojave të klientëve. Në këtë lëndë studentët do të kuptojnë rëndësinë strategjike të marketingut, si për kompanitë fitimprurëse ashtu edhe për organizatat jofitimprurëse. Pesha kryesore i kushtohet krijimit të vlerës për klientin, ndërtimit të marrëdhënieve afatgjata dhe përdorimit të mjeteve bashkëkohore të marketingut, duke përfshirë mediat sociale dhe platformat digjitale.

Objektivat e përgjithshme lëndorë: Të zhvillohet kuptimi i koncepteve bazë të marketingut. Të njihet rëndësia strategjike e marketingut në mjedisin modern të biznesit. Të kuptohet roli i marketingut në krijimin e vlerës dhe marrëdhënieve me klientin.

Objektivat specifike lëndorë:

1. Të kuptohen konceptet kryesore të marketingut dhe elementët e një strategjie marketingu.
2. Të identifikohen vendimet strategjike në lidhje me 4P-të e marketingut (produkt, çmim, promovim, shpërndarje).
3. Të përdoren mjetet tradicionale dhe digjitale të marketingut për të angazhuar klientët.
4. Të zhvillohen aftësi për planifikimin dhe implementimin e programeve të marketingut.

Rezultatet e pritshme: Pas përfundimit të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të:

1. Shpjegojnë konceptet dhe terminologjinë bazë të marketingut.
2. Aplikojnë njohuritë për hartimin e strategjive të marketingut.
3. Krijojnë dhe të matin vlerën për klientin.
4. Angazhojnë klientët përmes mjeteve tradicionale dhe digjitale.
5. Ndërtojnë marrëdhënie afatgjata e fitimprurëse me klientët.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

GJUHE E HUAJ D-2 TURQISHT

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore, 40 seminare

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti II, Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje

Programi i studimit: Program studimi profesional dyvjeçar "Komunikim Shumëgjuhësh në Institucione dhe Ndërmarrje"

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore: Studenti duhet të ketë njohuri themelore në gjuhën turke. Lënda gjuhë turke si gjuhë e dytë zhvillohet në dy module të vendosura në semestrin e parë dhe semestrin e dytë. Studentët do të punojnë me metodën e nivelit të avancuar, në nivelin C1 të metodës së përzgjedhur për mësim. Do dinë të përdorin aftësitë e të lexuarit kritik në gjuhën e huaj si leximi për të marrë kuptimin, për të nxjerrë konkluzione. Do përdorin strategji komunikimi.

Objektivat specifike lëndore: Shkrimi i prezantimeve, organizim i mësimit në gjuhën turke.

Puna me fjalor të avancuar duke përdorur hamendësimin, nxjerrjen e kuptimit nga konteksti, njohjen e parashtesave dhe prapashtesave. Zgjerimin e fjalorit duke përdorur përkufizimin, përdorimin e fjalëve në fjali.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHES GREKE**



**PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
GJUHË E HUAJ(GREKE) (D)**

Ngarkesa: 4 ECTS | 40 orë mësimore (40 seminare)

Viti akademik / semestri kur zhvillohet: Viti II, Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje

Programi i studimit: Programi i Studimit Profesional Dyvjeçar në “Komunikim shumëgjuhësh në Institucione dhe Ndërmarrje”

Kodi i etikës: Kodin e Etikës së UT-së, (Nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat specifike lëndore: Të zhvillojnë aftësi për të përdorur fraza dhe fjali të thjeshta në situata të përditshme, si prezantimet, përshëndetjet dhe bisedat bazë. Të aftësohen për të ndërtuar fjali të thjeshta në greqisht, duke përdorur strukturat gramatikore fillestare, si nyjat, përemrat dhe kohët kryesore të foljeve. Të përmirësojnë aftësinë për të kuptuar dhe interpretuar biseda dhe tekste të thjeshta në greqisht, të përshtatura për nivelin fillestar. Të zhvillojnë aftësi për të shkruar fjali të thjeshta mbi tema të njohura, si familja, puna dhe situatat e përditshme.

Rezultatet e pritshme:

1. Përdorin fraza dhe fjali të thjeshta për të komunikuar në situata të përditshme, si prezantime dhe përshëndetje.
2. Kuptojnë dhe japin informacion bazë për veten dhe të tjerët, si dhe të marrin pjesë në biseda të shkurtra dhe të thjeshta.
3. Lexojnë dhe kuptojnë tekste të thjeshta në greqisht, si mesazhe të shkurtra, përshkrime dhe formularë bazë.
4. Shkruajnë fjali dhe paragrafë të thjeshta në lidhje me tema të përditshme dhe personale, si familja dhe aktivitetet e përditshme.